

ASKUSH I LËNË PAS, AS TANI, AS KURRË

PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË PËRGJIGJEN NDAJ COVID-19¹

Kriza e shkaktuar nga Covid-19 është e re. Kjo krizë, kërkon nga të gjithë ne, që të ndërveprojmë dhe komunikojmë në mënyra të ndryshme nga ato që jemi mësuar deri tani. Megjithatë, pabarazitë, të cilat janë përkeqësuar nga impakti i Covid-19 për personat me aftësi të kufizuara nuk janë risi. Rreziku më i madh, si rezultat i përgjigjes ndaj krizës aktuale shëndetësore është që personat me aftësi të kufizuara do të ngelen sërish të papërfillur. Lajmi i mirë është sepse ne tashmë e dime se çfarë funksionon. Thelbësisht, ne na duhet drejtësi sociale, përfshirje efektive, barazi mundësish dhe punë të denja.

5 PIKA KRYESORE

1) Mbështetja e zgjidhjeve që promovojnë barazinë

Për shembull, politikat e të punuarit nga shtëpia, duhet të sigurojnë që punonjësit me aftësi të kufizuara të kenë mjetet e duhura në shtëpi, ashtu siç i kanë/ do duhet ti kishin, në vendet e tyre të punës. Masa të tjera të marra si përgjigje ndaj Covid-19, të tilla si vetëizolimi, duhet të llogarisin situatën e veçantë të personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë dhe faktin, që disa prej tyre mund të nevojitet ndihmë personale.

2) Sigurohuni që komunikimi është i aksesueshëm dhe gjithëpërfshirës për aftësinë e kufizuar

I gjithë komunikimi i shëndetit publik, informimit dhe i punës i lidhur me Covid-19, duke përfshirë këtu dhe rregullimet për punën online, duhet të jenë në formate të arritshme për personat me aftësi të kufizuara, duke përfshirë dhe gjuhën e shenjave, titrat dhe uebsajtet e aksesueshme. Komunikimi, duhet të adresojë gjithashtu situatën e veçantë të personave me aftësi të kufizuar

3) Siguroni mbrojtje shoqërore të përshtatshme

Mbrojtja sociale është thelbësore për personat me aftësi të kufizuara për të mbuluar kostot shtesë lidhur me aftësinë e kufizuar, të cilat mund të rriten për shkak të ndikimit të krizës dhe të çojnë drejt përçarjes të sistemit të tyre të mbështetjes. Personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht gratë me aftësi të kufizuara, përjetonin nivele të larta papunësie dhe përpara se të ndodhte kriza shëndetësore; tani, më shumë se kurrë masat e mbrojtjes shoqërore në termat gjinorë, do të duhet të krijohen në një mënyrë të tillë, që të mbështesin personat me aftësi të kufizuara që të hyjnë, të rrinë dhe të kenë përparim në tregun e punës.

4) Siguroni të drejtat e punës tani, të drejtat e punës gjithmonë

Në themel të lëvizjes për të drejtat e aftësisë së kufizuar dhe lëvizjes për të drejtat e punës, është dialogu dhe pjesëmarrja sociale. Kjo është e nevojshme më shumë se kurrë gjatë krizës aktuale. Një shumëllojshmëri pikëpamjesh nga qeveritë, organizatat e punëtorëve dhe punëdhënësve dhe organizatat e personave me aftësi të kufizuara, sjellin një shumëllojshmëri zgjidhjesh. Për të ndodhur kjo, është thelbësore zbatimi i standardeve ndërkombëtare të punës dhe instrumenteve të tjerë të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, veçanërisht Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

¹ https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_emp/---ifp_skills/documents/publication/wcms_741287.pdf

5) Ndryshoni qasjen ndaj trajtimit të aftësisë së kufizuar

Thelbësore për të gjitha këto pika është përfshirja e personave me aftësi të kufizuara si bashkëkrijues të përgjigjeve ndaj Covid-19, si kampionë dhe përdorues, jo si viktime. Të gjitha krizat sjellin mundësi dhe mundësia e momentit është përfshirja e të gjitha grupeve të marginalizuara më parë – duke përfshirë dhe personat me aftësi të kufizuara-një element qendror i të gjitha përgjigjeve. Duke u bazuar në përvojën tonë me përfshirjen e aftësisë së kufizuar dhe partneritetet, ne mund të mbështesim një përgjigje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse ndaj Covid-19.

“Për të avancuar drejtësinë shoqërore dhe për të përfshirë në mënyrë domethënëse personat me aftësi të kufizuara, duhet të jemi të guximshëm. Ne duhet të jemi inovativë. Dhe ne duhet të veprojmë së bashku - gjatë krizës së COVID-19 dhe më gjerë.”

Ky dokument është përkthyer dhe përshtatur në gjuhën shqipe nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në kuadrin e projektit “ COVID-19, Reagim Përfshirës për Aftësinë e Kufizuar”, të mbështetur financiarisht nga Ballkan Trust for Democracy(BTD). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e BTD.

Për të marrë informacione të mëtejshme në lidhje me aftësinë e kufizuar dhe Covid-19, ju mund të lexoni materialet e publikuara në faqen tonë : <https://platforma-pak.al/te-drejtat-e-personave-me-aftesi-te-kufizuara-dhe-covid-19/>, ku keni dhe hapësirën e posaçme dedikuar për pyetjet tuaja.

